



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	2-D / DPKI
Nr. (faq. / Broj. stranica / Nr. pages)	02
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	01-1853/13
Data / Datum / Date	14-06-2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **05.06.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-244/13 për z. Mërgim Lushtaku – Drejtor i Departamentit për integritete evropiane, kordinim të politikave (DIEKP) në Ministrinë e Administratës Publike (MAP), për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-244-13, për Zyrtarin e lartë, z. Mërgim Lushtaku–Drejtor i DIEKP-it Ministrine e Administrates publike (MAP), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-244/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Lushtaku së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPKI-01-667/2013), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, z.Lushtaku është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z.Lushtaku në Agjenci ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-1752/13), në të cilën shihet se z.Lushtaku ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte te “Virtyti” Sh.p.k.,

duke autorizuar një person të besuar, për të ushtruar vet funksionin e tij si zyrtar i lartë publik në Ministrinë e Administratës Publike(MAP).

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

